Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Remzi Llumnica	**15.08.2023**	**17.08.2023**	**2023/0569**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **11.08.2023, OE "Flamur Isufi B.I."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0569**, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Flamur Isufi B.I."- Prishtinë, apo **kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ""**Furnizim me pajisje per laboratoret mikrobiologjik ne IKSHPK**"" me nr. të prokurimit: "**206-23-651-1-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**.Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, **furnizim**, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: Lot -2 / **165,600.00 €**.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0569 i dt:11.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

- **Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

Ju rikujtojmë se njoftimi për kontratë ishte bërë me dt.16.02.2023, ndërsa hapja e ofertave ishte bërë me dt.12.04.2023 ku kishin marr pjesë katër operator ekonomik për Lot 2.

Njoftimi mbi vendimin ishte publikuar me dt.16.05.2023 ku ne ishim rekomanduar për kontratë për Lot 2.

Në lidhje me këtë njoftim nuk kishte pasur kërkesë për rishqyrtim e as ankesë.

Publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës ishte bërë me dt.24.05.2023, e ku ishte planifikuar

nënshkrimi i kontratë për dt.24.05.2023.

Më pastaj na ishte dërguar drafti i kontratës. Pas këtij veprimi ishte tërhequr drafti i kontratës, kurse me dt.28.07.2023 ishte publikuar njoftimi për anulim të dhënies së kontratës, e ku ishin she njëzuar arsyet si në vijim:

IV.4) Arsyeja e anulimit të njoftimit të dhënies së kontratës:

x Një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit"

? Ri-vlerësim i aktivitetit të prokurimit.

x Anulim dhe Ri-tenderim i aktivitetit të prokurimit

x Një rekomandim i lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kërkon anulimin e njoftimit për dhënie te kontratës

? Ne përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 te LPP-se

- **Procesi i Hapjes së tenderëve**Me date 12.04.2023 kemi marre pjese ne aktivitetin e prokurimit me titull:"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" dhe me numer teprokurimit: 206-23-651-1-1-.Ne kete aktivitet kemi ofertuar per LOT 1, LOT 2, LOT 3 dhe LOT 4.
- **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 9 i LPP-së

Neni 26 i LPP-së

Neni 39.11 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 42.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Pretendimet ankimore OPERATORI EKONOMIK - "OE "Flamur Isufi B.I."- Prishtinë.

- **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Anulimi i Dhënies se kontratës për LOT 2 bëhet me kërkesën e Sekretarit te Përgjithshëm me Nr.protokolli 05-4516 te datës 24.07.2023, me te cilën ZKA e ka njoftuar ZPP te Divizionit te Prokurimit qe Andaj nga ana juaj kërkoj që të procedoni në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik në anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit . Sekretari i Përgjithshëm ka refuzuar ta nënshkruaj kontratën dhe ka kërkuar qe kontrata te anulohet, me arsyetimin se specifikat teknike janë hartuar ne mënyrë qe kanë favorizuar prodhues specifik, duke e kufizuar konkurrencën. Bazuar ne opinionin e KRPP-së, ZKA ka kërkuar ekspertizë nga njësia

e Bankës Botërore, me çka bazuar ne opinionin e tyre është arritur ne përfundimin e këtij aktiviteti.

Pas këtij publikimi, ne kemi kërkuar qasje dhe na është lejuar qasja në dokumentacion.

Arsyetimi i AK-së për anulimin e dhënies së kontratës është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne jemi shpallur si tenderues të suksesshëm, pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, fakt ky i vërtetuar nga vet AK□ja, pasi që e njëjta na ka dërguar edhe draft-kontratën për këtë lot.

Një vendim kundërligjor për anulim të dhënies së kontratës (faza para nënshkrimit të kontratës) përveç që nuk duhet të ndodh pasi që nuk ka asnjë arsye për anulimin e këtij njoftimi, njëkohësisht neve na shkakton edhe dëme të mëdha materiale.

Anulimi i dhënies së kontratës me kërkesë të sekretarit tw pwrgjithshwm përbën shkelje flagrante ligjore edhe nga ana e zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe njëkohësisht përbën ndërhyrje të paligjshme të sekretarit në procedurë tenderuese.

Specifikat teknike i harton njësia kërkuese dhe më pastaj janë kaluar filtrat e tjerë për vlerësim të ofertave, ndërsa në fund sekretari vjen me konstatim se janë përshtat specifikat prodhuesit specifik.

AK-ja e ka cekur opinionin e KRPP si bazë për të kërkuar ekspertizë nga njësia e Bankës Botërore dhe duke u bazuar në opinionin e tyre është përfunduar ky aktivitet i prokurimit.

Sa i përket këtij arsyetimi, ne kemi analizuar opinionin e KRPP-së të dt.29.06.2023 me Nr.46/23 e ku ky opinion absolutisht nuk i jep të drejtë AK-së dhe sekretarit që të anulojë njoftimin për dhënie të kontratë dhe absolutisht nuk theksohet se sekretari ka të drejtë të ndërhyjë në proces të prokurimit e as në fazën në të cilën ka ndërhy sekretari.

Me dt.24.07.2023 Sekretari i përgjithshëm i ka dërguar një shkresë Dr. Naser Ramadani - Drejtorit Ekzekutiv të IKSHPK ku ka sqaruar se nga divizioni i prokurimit i është dërguar kontrata për nënshkrim në lidhje me këtë tender, me çka kuptohet se përderisa i është dërguar kontratë për nënshkrim kuptohet që kjo kontratë është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i Prokurimit.

Po në atë shkrese ceket se me dt.21.07.2023 është informuar nga zyrtarët e Bankës Botërore se kriteret e tenderit kanë qenë të kopjuara nga prodhues specifik dhe se specifikat janë shumë të ngjashme me ato të:

1. Water still:LAUDA, Puridest PD 8 R

2. Incubator: POL- EKO, Laboratory Incubator CLN 115

3. Cooled incubator POL-EKO Cooled Incubator ST 3(partial similarity)

4. Sterilizator:POL- EKO, SL W 240 Smart

5. Water bath: LAUDA, Hydro H 16 A

6. Hot plate stirrer: AREX, Analog Stirrer 20L

7. Tube rotator: VËR, Tube Rotator,

8. Shaker 3D: OHAUS, Model SHRK04DG

9. Colony Counter: ISOLAB, Colony Counter

Nga ky tekst, e i cili i referohet mendimit të zyrtarëve të Bankës Botërore kuptohet qartë se askund nuk shkruan se ka përshtatje të specifikave por shkruan se janë të ngjashme dhe janë kopjuar nga prodhues specifik.

Pra shihet qartë se nuk ka përshtatje të specifikimeve, prandaj edhe brenda shkresave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe komunikimeve me zyrtarë të bankës botërore ka mospërputhje dhe kundërthënie sepse edhe nga zyrtarë të bankës Botërore është thënë se specifikat janë të ngjajshme e nuk thuhet se janë të njëjta, pavarësisht që thuhet se ka kopjime nga prodhues specifik.

Nga të gjitha këto shkresa kuptohet se tendenca e AK-së ka qenë diskriminimi dhe dëmtimi i kompanisë tonë.

Zyrtarët e njësisë së Bankës Botërore dhe sekretari i përgjithshëm nuk janë kompetent për specifikime teknike dhe për përgatitjen e tyre por janë njësia kërkese, e cila si çdo herë i përgatit specifikimet teknike.

Me veprimin e sekretarit të përgjithshëm duke i përfshirë në lojë edhe zyrtarë të njësisë së bankës botërore është vepruar kundërligjshëm dhe ky veprim është ndërhyrje në procedura të prokurimit.

SE NUK KA PAS PËRSHTATJE TË SEPCIFIKIMEVE TEKNIKE, NE PO JU BASHKANGJESIM NJË TABELË ME PRODHUES TË TJERË E KU KUPTOHET QË NUK ËSHËT KUFIZUAR KONKURRENCA.

Normalisht që ka edhe prodhues të tjerë, por në mungesë të kohës për dorëzim të kërkesës për rishqyrtim ne po e bashkangjesim tabelën që e cekëm më lartë.

- **Dëmet materiale**

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 4 mijë euro deri më tani pa llogaritur dëmet që rrezikohen të na shkaktohen.

Përgjigje dhe pretendimet ankimore të AK . AUTORITETI KONTRAKTUES - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim nga "OE "Flamur Isufi B.I."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje per laboratoret mikrobiologjik ne IKSHPK" me nr. të prokurimit: 206-23-651-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË.

1. Vndimi i AK mbi kerkesen per rishqyrtim nga OE ankues NTP ERAMED i dates 21.03.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

Prishtine datë, 21.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë se Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores per Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **15.03.2023,** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.T.P ERAMED** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"** me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik N.T.P ERAMED të dt. 15.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontraktues (Njoftim për dhënie të Kontratës, të datës 15.02.2023 te publikuar ne platformën elektronike.

2. **Plotësohet/ndryshohet** kriteri nr. 6 i Përshtatshmërisë profesionale ne dosje te tenderit, ne lidhje me certifikaten ISO 13485;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P ERAMED me datë 15.03.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"** me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 21.03.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE N.T.P ERAMED:

Nenin 1 - Qëllimi
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Pretendimi ankimor

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Neni: 7.1 & 7.2; Evidenca 6. Te dëshmohet me kopjen e Certifikatës ISO 13485 të prodhuesit-(valide).

Pergjigja nga AK-se ndaj kerkeses sone eshte: Referoju dosjes se tenderit

Ne kete aktivitet te prokurimit ka pajisje qe nuk prodhohen dhe nuk klasifikohen sipas ISO 13485 si psh: nga LOT 1 te gjithe artikujt prodhohen sipas standardeve EN 12469 – Standard Europian qe specifikon kriteret per kabinetet e sigurise mikrobiologjik si dhe standardi EN1822.1 per HEPA filtrat qe integrohen ne kabinet dhe luajn rolin kryesor per sigurimin e hapsires sterile brenda kabinetit.

Bashkrngjitur broshura dhe CE deklarata per LOT 1 - artikullin 1.

Ne CE deklarate eshte e cekur shume kjarte konformiteti i pajisjes, ne kete rast kabinetit te sigurise sipas standardit EN12469.

Si prodhues i BE-se ne rast se do te ishte kusht qe pajisja te jete konform standadid ISO 13485 prodhuesi do te detyrohej te certifikoj pajisjen edhe me kete standard.

Ne qoftese AK ka patur ndermend qe furnizuesi ose OE te jene te certifikuar me ISO 13485 - Shitja dhe shperndarja e pajisjeve mjekesore atehere si kerkese do te ishte e arsyshme sepse do te definonte ata OE te cilet kane pervojen e duhur ne fushen e pajisjeve mjekesore.

Ju lutemi gjeni te bashkengjitur certifikaten tone ISO 13485 per te cilen ne jemi te certifikuar.

Autoriteti Kontraktues mund te shkaktoj eliminim jo thjesht konkurencen, por edhe qellimin ligjor per te cilin zhvillohet ky aktivitet i prokurimit duke kufizuar pjesemarrjen me te gjere te OE e cila eshte ne kundershtim me Ligjin e Prokurimit.

Bazuar ne kete fakt ne edhe kemi bere kerkese per informacione shtese (te cilen e keni refuzuar) qe te kerkohet certifikata ISO 13485 vetëm tek produktet ku është i aplikueshëm ky standard.

Andaj, nga ato qe u ceken me larte dhe bazen ligjore lidhur me kete procedure tenderuese kerkojme qe te pranohet kerkesa jone nga ana e AK-se qe certifikata ISO 13485 te kërkohet vetëm për produktet për te cilat është i aplikueshëm ky standard dhe te na mundesohet te ushtrojme te drejten tone per pjesemarrje si OE.

Pergjigjia e Autoritetelt Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

AK-Ministria e Shëndetësisë pajtohet me kërkesën tuaj për rishqyrtim te parashtruar për AP, për Lotin 1 korrigjohet kriteri nr. 6 i Përshtatshmërisë profesionale ne dosje te tenderit, dhe ky kriter - Certifikata ISO 13485 e prodhuesit me validitet, kërkohet vetëm për Lot 2, 3 dhe 4, ndërsa nuk kërkohet për Lot 1.

Ne e-prokurim do te behet korrigjimi i kriterit përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. N.T.P ERAMED
2. Operatoreve ekonomik te interesuar

Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

2. Vndimi i AK mbi kerkesen per rishqyrtim nga OE ankues NTP ERAMED i dates 30.03.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

Prishtine datë, 30.03.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë se Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores per Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **23.03.2023,** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.T.P ERAMED** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"** me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik N.T.P ERAMED të dt. 15.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës 15.02.2023 te publikuar ne platformën elektronike.

2. **Hiqet** kriteri nr. 6 i Përshtatshmërisë profesionale ne NJK dhe DT (nuk kerkohet certifikata ISO 13485);

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **N.T.P ERAMED** me datë 23.03.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **""Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"** me numër prokurimi: 206-23-651-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.03.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE N.T.P ERAMED:

Nenin 1 - Qëllimi
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Art. 3 - Laboratory freezer - Ky artikull prodhohet sipas standardeve EN 61010 dhe EN 60529 – Standarde Europiane qe specifikon kriteret per friz, siguria e matjes se temperatures, kontrolla dhe perdorimi laboratorik.

Si prodhues i BE-se ne rast se do te ishte kusht qe pajisja te jete konform standadid ISO 13485 prodhuesi do te detyrohej te certifikoj pajisjen edhe me kete standard.

Autoriteti Kontraktues mund te shkaktoj eliminim jo thjesht konkurencen, por edhe qellimin ligjor per te cilin zhvillohet ky aktivitet i prokurimit duke kufizuar pjesëmarrjen me te gjere te OE e cila eshte ne kundershtim me Ligjin e Prokurimit.

Bazuar ne kete fakt ne bejme prap bere kerkese qe te kerkohet certifikata ISO 13485 vetëm tek produktet ku është i aplikueshëm ky standard.

Andaj, nga ato qe u ceken me larte dhe bazen ligjore lidhur me kete procedure tenderuese kerkojme qe te pranohet kerkesa jone nga ana e AK-se qe certifikata ISO 13485 te kërkohet vetëm për produktet për te cilat është i aplikueshëm ky standard dhe te na mundesohet te ushtrojme te drejten tone per pjesemarrje si OE.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

MSh e ka shqyrtuar Kërkesën tuaj te pare për rishqyrtim te datës 15.03.2023 duke u pajtuar me pretendimet e juaja ankimore dhe duke e hequr kriterin e certifikatës ISO 13485 për Lot 1.
Me datën 23.03.2023 ju përsëri keni bere Kërkesë për Rishqyrtim duke kërkuar qe kjo certifikate te hiqet edhe për lotët 2 dhe 3.

Edhe përkundër faktit qe u kemi dërguar Vendimin e Rishqyrtimit te datës 21.03.2023, duke marre parasysh rëndësinë e projektit, si Div. i Prokurimit ne MSh kemi kërkuar qe kërkesa juaj e datës 23.03.2023 te shqyrtohet nga përgjegjësit ne IKSHPK dhe konform rekomandimit nga IKSHPK ne pajtohemi me kërkesën tuaj për rishqyrtim te parashtruar te datës 23.03.2023, me ç'rast **Për te gjitha Lot-et hiqet kriteri nr. 6 i Përshtatshmërisë profesionale ne NJK dhe DT (nuk kërkohet certifikata ISO 13485);**

Ne e-prokurim do te behet korrigjimi i kriterit përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. N.T.P ERAMED
2. Operatoreve ekonomik te interesuar

Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

3. Vndimi i AK mbi pezullimin e Aktivitetit te Prokurimit i dates 16.03.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurment Division

DATË/A:	**16.03.2023**
PËR/ZA/TO:	**Operatorët ekonomik**
NGA/OD/FROM:	**Berat Marmullaku**, zv. Udhëheqës i Div. Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**VENDIM,** mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit **"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"**

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, ka pranuar Kërkesë për Rishqyrtim nga operatori ekonomik: Flamur Isufi B.I. - NTP "ERAMED" nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"** me nr. prokurimi 206-23-651-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, te datës 15.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK" me nr. prokurimi 206-23-651-1-1-1.

Vendimi i dorëzohet:

1. 1 x 1 Flamur Isufi B.I. - NTP "ERAMED"
2. 1 x 1 Operatoreve ekonomik te interesuar

Me respekt.

4. Njoftim nga AK mbi rezultatin e Aktivitetit te Prokurimit i dates 16.05.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Departamenti i Prokurimit/Department nabavke /Procurment Departmenta

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"

Nr. i prokurimit	206-23-651-1-1-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Lot	Vlera totale e ofertave
1.	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	Lot 1	57,100.00
2.	"KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY PHARMACEUT)"SH.P.K., VELANIA II NR.6, -, PRISHTINË	Lot 1	58,905.60
3.	Vitech Sh.p.k., Rr. Vicianum nr. 210, 10000, PRISHTINË	Lot 1	59,802.45
4.	N.SH. " TRIMI MED ", mirko gashi, 10000, prishtine	Lot 1	66,071.00
5.	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	Lot 1	66,999.00
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik Interlab SH.P.K.; Delta HealthCare SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani, Nr.65, -, Prishtine	Lot 1	75,255.00
7.	Flamur Isufi B.I., Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	Lot 1	91,800.00
8.	Grup i Operatorëve Ekonomik RSR KOSOVA L.L.C.; RSR EOOD, Hilmi Rakovica Nr. 68,, 10000, Prishtinë	Lot 1	101,988.31
9.	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	Lot 2	94,420.00
10	N.SH. " TRIMI MED ", mirko gashi, 10000, prishtine	Lot 2	108,630.00
11.	Grup i Operatorëve Ekonomik Interlab SH.P.K.; Delta HealthCare SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani, Nr.65, -, Prishtine	Lot 2	148,591.65

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

12.	Flamur Isufi B.I., Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	Lot 2	165,180.00
13.	Grup i Operatorëve Ekonomik Interlab SH.P.K.; Delta HealthCare SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani, Nr.65, -, Prishtine	Lot 3	30,632.25
14.	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	Lot 3	47,565.00
15.	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	Lot 3	58,100.00
16.	Flamur Isufi B.I., Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	Lot 3	72,050.00
17.	"KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY PHARMACEUT)"SH.P.K., VELANIA II NR.6, -, PRISHTINË	Lot 3	99,568.40
18.	MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë	Lot 4	42,250.00
19.	KO MED L.L.C., Jakov Xoxa, 10000, PRISHTINË	Lot 4	47,850.00
20.	"KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY PHARMACEUT)"SH.P.K., VELANIA II NR.6, -, PRISHTINË	Lot 4	57,230.00
21.	Grup i Operatorëve Ekonomik RSR KOSOVA L.L.C.; RSR EOOD, Hilmi Rakovica Nr. 68,, 10000, Prishtinë	Lot 4	67,378.00
22.	Grup i Operatorëve Ekonomik Interlab SH.P.K.; Delta HealthCare SH.P.K., Rr. Idriz Gjilani, Nr.65, -, Prishtine	Lot 4	67,620.00
23.	Flamur Isufi B.I., Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË	Lot 4	77,500.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Shëndetësisë **shpërblen** me kontratë:

- *Për Lot 1 – OE KO MED L.L.C në vlerën e ofertës prej 57,100.00 €,*
- *Për Lot 2 – OE Flamur Isufi B.I në vlerën e ofertës prej 165,180.00 €,*
- *Për Lot 3 – OE Flamur Isufi B.I në vlerën e ofertës prej 42,250.00 €,*

Ministria e Shëndetësisë **Anulon** lotin 4 ne mungesë te ofertave të përgjegjshme.

Data: 16.05.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP: Berat Marmullaku
[Nënshkrimi]

5.Leter Standarde per tenderuesin e suksesshem i dates 16.05.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Departamenti i Prokurimit/Department Nabavke/Procurment Departmenta

Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm

15.05.2023 Prishtinë

Ministria e Shëndetësisë, rr. e Zagrebit pn. ish spitali i mushkërive, lagja Arbri zyra nr 009

Flamur Isufi B.I, Vasil Andoni, -10000, PRISHTINË

Nr. i prokurimit	**206-23-651-1-1-1**

Titulli: "Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"

Te nderuar,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, siç citohet në vazhdim "LPP " i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *tenderin me çmimin më të ulët* si përgjigje ndaj *[njoftimit të prokurimit publik]* për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj:

Për Lot 2 – shuma e kontratës është 165,180.00 €,

Për Lot 3 – shuma e kontratës është 42,250.00 €,

dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,

[Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit] *[Nënshkrimi]*

6.Njoftim per anulimin e dhenies se kontrates i dates 27.07.2023

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

NJOFTIMI PËR ANULIMIN E DHËNIES SË KONTRATËS

Data e përgatitjes së njoftimit: 27.07.2023

Nr i Prokurimit	**206-23-651-1-1-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTOARITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**		
Adresa Postare: **ZAGREBIT , P.N.**		
Qyteti: **PRISHTINË**	Kodi postar: **-**	Vendi: **Kosovë**
Personi Kontaktues: **Egzon Ukshini**		Telefoni: **038 200 24 136**
Email: **egzon.ukshini@rks-gov.net**		Faksi:
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): **https://msh.rks-gov.net/sq/**		

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët
Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit
Po ☐ Jo ☒

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
"Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK"

Pjesë (lot)
Pjesë (LOT) 2

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☐ **Punë**	☒ **Furnizime**	☐ **Shërbime**

B11 Njoftimi per anulimin e dhenies se kontrates 1 / 3

☐ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☒ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve
IKSHPK-Prishtinë dhe QRSHP (Mitrovice, Peje, Gjakove, Prizren, Ferizaj, Gjilan.

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
Po ☐

II.1.4) Përshkrimi i shkurtër i lëndës së kontratës.
Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK (4 Lote)

II.1.5) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP)
33000000-0

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

☒ E hapur ☐ E kufizuar ☐ E negociuar ☐ Konkurruese me negociata

☐ Kuotim i çmimit

III.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**
apo
☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**

III.3)) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë
Njoftimi paraprak ,
Njoftimi për kontratë **2023/206-23-651-1-1-1/B05-0003387, 16.02.2023**
Njoftimi i dhënies së kontratës **2023/206-23-651-1-1-1/B08-0012599, 25.05.2023**
Publikimet e tjera (*nëse aplikohen)*
od
od

NENI IV: ANULIMI I DHËNIES SË KONTRATËS

IV.1) Data e vendimit mbi anulimin e njoftimit të dhënies së kontratës 27.07.2023

B11 Njoftimi per anulimin e dhenies se kontrates 2 / 3

IV.2) Numri i tenderëve të pranuar 8

IV.3) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të cilit i ishte dhënë kontrata
Flamur Isufi B.I., Vasil Andoni, PRISHTINË

IV.4) Arsyeja e anulimit të njoftimit të dhënies së kontratës:

